



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2967/11 prot.

Datë 05.12.2025

V E N D I M

Nr.1811/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e dates 05.12.2025 me

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1691/2025, datë 17.11.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-55989-07-23-2025, me objekt: “Mirembajtje 3 vjecare e ashensoreve”, me fond limit 4,783,050.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 03-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “CLASS ASHENSOR” SHPK me NIPT L01325010Q dhe adresë: Rruga Hasan Vogli, Zona Kadastrale 3292, Nr. Pasurie 68/68-d2, Selitë, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a. Adresa. Bulevardi Gjergj Fishta, Tirana.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi nr. 285, datë 19.05.2021 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit 2 Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 17.11.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1691/2025, ku vendosi:

1. *“Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Class Ashensor” Shpk për procedurën e prokurimit në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-55989-07-23-2025, me objekt: “Mirembajtje 3 vjecare e ashensoreve”, me fond limit 4,783,050.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 03-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.*
2. *Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi, për operatorin ekonomik “Class Ashensor” Shpk.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Class Ashensor” Shpk.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”

I.2. Me shkresën nr.10755/2 prot., datë 27.11.2025, protokolluar me tonën nr. 2967/8 prot., datë 02.12.2025, autoriteti kontraktor Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1691/2025, datë 17/11/2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-55989-07-23-2025, me objekt: “Mirembajtje 3 vjecare e ashensoreve”, me fond limit 4,783,050.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 03-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr.10755/2 prot., datë 27.11.2025, protokolluar me tonën nr. 2967/8 prot., datë 02.12.2025, autoriteti kontraktor Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1691/2025, datë 17/11/2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-55989-07-23-2025, me objekt: “Mirembajtje 3 vjecare e ashensoreve”, me fond limit 4,783,050.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 03-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

II.2. Referuar shkresës së dorëzuar nga autoriteti kontraktor me nr.10755/2 prot., datë 27.11.2025, protokolluar me tonën nr. 2967/8 prot., datë 02.12.2025, ku autoriteti kontraktor Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1691/2025, datë 17/11/2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit Nr. 1691/2025, datë 17/11/2025, nga ku rezultoi, se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në përputhje dhe në zbatim të vendimit të Komisioni i Prokurimit Publik Nr. 1691/2025, datë 17/11/2025.

II.3. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, që autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr. 1691/2025, datë 17/11/2025, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor, për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-55989-07-23-2025, me objekt: *“Mirembajtje 3 vjecare e ashensoreve”, me fond limit 4,783,050.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 03-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.*
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fioorent Zguro

